

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 530

## ZGJEDHJA NË AUDITIM

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je	1-2
Hyrja në fuqi	3
<b>Objektivi</b>	4
<b>Përkufizimet</b>	5
<b>Kërkesat</b>	
Përcaktimi i Kampionit, Madhësia dhe Përzgjedhja e Elementëve për t'u Testuar	6-8
Kryerja e Procedurave të Auditimit	9-11
Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Anomalive	12-13
Projektimi i Anomalive	14
Vlerësimi i Rezultateve të Zgjedhjes në Auditim	15
<b>Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese</b>	
Përkufizime	A1-A3
Përcaktimi i Kampionit, Madhësia dhe Përzgjedhja e Elementëve për t'u Testuar	A4-A13
Kryerja e Procedurave të Auditimit	A14-A16
Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Anomalive	A17
Projektimi i Anomalive	A18-A20
Vlerësimi i Rezultateve të Kampionit	A21-A23
Shtojcë 1: Shtresëzimi dhe Zgjedhja e Vlerës së Ponderuar	
Shtojcë 2: Shembuj të Faktorëve që Influencojnë në Madhësinë e Kampionit për Testet e Kontrolleve	
Shtojcë 3: Shembuj të Faktorëve që Influencojnë në Madhësinë e Kampionit për Testet e të Dhënave	
Shtojcë 4: Metodatat e Zgjedhjes së Kampionit	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 530, "Zgjedhja në Auditim" duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 "Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit".

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) zbatohet kur audituesi ka vendosur të përdorë metodën e zgjedhjes së kampionit në kryerjen e procedurave të auditimit. Ai ka të bëjë me përdorimin nga ana e audituesit të zgjedhjes statistikore dhe jo-statistikore kur projekton dhe përzgjedh kampionin në auditim, me kryerjen e testeve për kontrollin e brendshëm, testeve të të dhënave si dhe me vlerësimin e rezultateve të kampionit.
2. Ky standard plotëson standardin 500<sup>1</sup>, i cili ka të bëjë me përgjegjësinë e audituesit për të projektuar dhe për të kryer procedura auditimi për të siguruar evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme në auditim për të qënë i aftë të nxjerrë konkluzione të arsyeshme mbi të cilat do të bazohet opinioni i audituesit. Standardi 500 jep udhëzime mbi mjetet e përdorshme nga audituesi për zgjedhjen e elementëve për testim, ku zgjedhja në auditim është një nga mjetet.

### Hyrja në Fuqi

3. Ky standard ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

### Objektivi

4. Objektivi i audituesit, kur përdor metodën e zgjedhjes në auditim, është të sigurojë baza të arsyeshme për audituesin për të nxjerrë konkluzione rreth popullatës nga e cila ky kampion është përzgjedhur.

### Përkufizimet

5. Për qëllimet e SNA-ve, shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e dhëna si më poshtë:
  - a) Zgjedhja në auditim (zgjedhja e kampionit) – Zbatimi i procedurave të auditimit në më pak se 100 për qind të elementëve brenda një popullate të auditimit, të atillë që të gjitha njësitë të kenë shansin të zgjidhen, në mënyrë që t'i japin audituesit një bazë të arsyeshme mbi të cilën ai të nxjerrë konkluzionet për të gjithë popullatën.
  - b) Popullata - E gjithë seria e të dhënave nga e cila është zgjedhur një kampion dhe për të cilën audituesi dëshiron të nxjerrë konkluzionet.
  - c) Rreziku i metodës me zgjedhje (zgjedhjes së kampionit) - Rreziku që konkluzioni i audituesit i bazuar në një zgjedhje, mund të jetë i ndryshëm nga konkluzioni që mund të nxirrej, nëse e gjithë popullata do të ishte subjekt i së njëjtës procedurë

<sup>1</sup>SNA 500, *Evidenca në Auditim*.

auditimi. Rreziku i metodës me zgjedhje mund të çojë në dy tipe konkluzionesh të gabuara:

- (i) Në rastin e testeve të kontrolleve, që kontrollet janë më shumë efektive nga sa janë në të vërtetë, ose në rastin e testeve të detajeve, që një anomali materiale nuk ekziston, kur në fakt ajo ekziston. Audituesi është kryesisht i interesuar për këtë tip konkluzioni të gabuar, pasi ai ka ndikim në efektivitetin e auditimit dhe ka më shumë të ngjarë të çojë në një opinion auditimi të papërshtatshëm.
  - (ii) Në rastin e testeve të kontrolleve, që kontrollet janë më pak efektive nga sa ato janë në të vërtetë, ose në rastin e testeve të detajeve, që një anomali materiale nuk ekziston, kur në fakt ajo ekziston. Ky tip konkluzioni i gabuar ka ndikim në efikasitetin e auditimit, pasi ai si rregull, çon në punë shtesë për të konfirmuar se konkluzionet fillestare kanë qënë jo-korrekte.
- d) Rreziku i auditimit pa zgjedhje – Rreziku që audituesi të arrijë një konkluzion të gabuar për çfarëdo arsye që nuk lidhet me rrezikun e auditimit me zgjedhje. (Ref: Para. A1)
- e) Anomali – Një anomali ose devijim që demonstroi të mos jetë përfaqësues i anomalive apo devijimeve në një popullatë.
- f) Kampioni – Zërat individualë që përbëjnë një popullatë. (Ref: Para. A2)
- g) Zgjedhja statistikore – Një metodë e zgjedhjes që ka karakteristikat e mëposhtme:
- (i) Kampioni zgjidhet në mënyrë rastësore, dhe
  - (ii) Për të vlerësuar rezultatet e kampionit, përfshirë edhe matjen e rrezikut të zgjedhjes, përdoret teoria e probabilitetit.
- Një metodë e auditimit me zgjedhje që nuk ka karakteristikat (i) dhe (ii) konsiderohet metodë e auditimit me zgjedhje jo-statistikore.
- h) Shtresëzimi - Shtresëzimi është procesi i ndarjes së popullatës në nën-popullata, ku secila prej tyre përfaqëson një grup kampionësh, të cilët kanë karakteristika të ngjashme (shpesh vlera monetare).
- i) Anomali e tolerueshme – Një shumë monetare e përcaktuar nga audituesi në lidhje me të cilën audituesi kërkon të sigurojë një nivel të përshtatshëm të sigurisë, se kjo shumë monetare e përcaktuar prej tij nuk do të tejkalohet nga anomalia aktuale në popullatë. (Ref: Para. A3)
  - j) Niveli i tolerueshëm i devijimit – Një nivel devijimi nga procedurat e kontrollit të brendshëm i vendosur nga audituesi, lidhur me të cilin audituesi kërkon të sigurojë një nivel të përshtatshëm të sigurisë se niveli i devijimit i përcaktuar prej tij nuk do të tejkalohet nga niveli aktual i devijimit në popullatë.

## Kërkesat

### Përcaktimi i Kampionit, Madhësia dhe Zgjedhja e Elementëve për tu Testuar

6. Kur planifikohet një zgjedhje në auditim, audituesi duhet të marrë në konsideratë qëllimin e procedurave të auditimit dhe karakteristikat e popullatës nga e cila do të nxirret dhe kampioni. (Ref: Para. A4-A9)
7. Audituesi duhet të përcaktojë një madhësi kampioni të mjaftueshme për të ulur rrezikun në zgjedhjen e kampionit në një nivel të ulëttë pranueshëm. (Ref: Para. A10-A11)
8. Audituesi duhet të përzgjedhë elementë për zgjedhjen në një mënyrë të tillë që secili kampion brenda një popullate të auditimit të ketë shansin të zgjidhet. (Ref: Para. A12-A13)

### Kryerja e Procedurave të Auditimit

9. Audituesi duhet të kryejë procedurat e auditimit, të përshtatshme për qëllimin, për secilin element të përzgjedhur.
10. Në qoftë se procedura e auditimit nuk është e aplikueshme për elementin e përzgjedhur, audituesi duhet të kryejë procedurën mbi një element zëvendësues. (Ref: Para. A14)
11. Në qoftë se audituesi nuk është në gjendje të zbatojë procedurat e përcaktuara të auditimit, ose procedura alternative të përshtatshme mbi një element të përzgjedhur, audituesi duhet ta trajtojë atë element si një devijim nga kontrolli i parashikuar në rastin e testeve për kontrollin e brendshëm, ose si një anomali në rastin e testeve të të dhënave. (Ref: Para. A15-A16)

### Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe i Anomalive

12. Audituesi duhet të hetojë natyrën dhe shkakun e çdo devijimi ose anomalie të identifikuar dhe të vlerësojë ndikimin e tyre të mundshëm mbi qëllimin e procedurës së auditimit dhe mbi fushat e tjera të auditimit. (Ref: Para. A17)
13. Në situata jashtëzakonisht të rralla kur audituesi e gjykon një anomali ose devijim të gjendur në një zgjedhje të jetë një anomali, audituesi duhet të përdorë një shkallë të lartë sigurie që një anomali e tillë ose devijim nuk përfaqëson popullatën. Audituesi duhet ta arrijë këtë shkallë sigurie duke kryer procedura auditimisthesë për të siguruar evidencë të përshtatshme e të mjaftueshme auditimi që anomalia ose devijimi nuk ndikon në pjesën e mbetur të popullatës.

### Projektimi i Anomalive

14. Për testet e të dhënave, audituesi duhet të përcaktojë anomalitëe gjetura në kampion lidhur me popullatën. (Ref: Para. A18-A20)

## Vlerësimi i Rezultateve tëKampionit

15. Audituesi duhet të vlerësojë:

- (a) Rezultatet e kampionit; dhe (Ref: Para. A21-A22)
- (b) Nëse përdorimi i zgjedhjes në auditim ka siguruar nje bazë të arsyeshme për konkluzionet rreth popullatës qëështë marrë në testim. (Ref: Para. A23)

\*\*\*

## Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

### Përkufizime

*Rreziku i auditimit pa zgjedhje* (Ref: Para. 5(d))

- A1. Shembuj të rrezikut të auditimit pa zgjedhje përfshijnë përdorimin e procedurave të papërshtatshme të auditimit ose keqinterpretimin e evidencave të auditimit dhe neglizhimin për të njohur një anomali ose devijim.

*Kampioni* (Ref: Para. 5(f))

- A2. Kampionet mund të jenë elementë fizikë (për shembull, çeqet e listuara në mandatet e depozitimit, kreditimet nënjerrjet e llogarive bankare, faturat e shitjeve ose gjendjet e debitorëve) ose njësi monetare.

*Anomali e Tolerueshme* (Ref: Para. 5(i))

- A3. Në përcaktimin e njëkampioni, audituesipërcakton anomalinë e tolerueshme me qëllim trajtimin e rrezikut qëbashkimi i anomalive jomateriale individuale mund tëbëjë që pasqyrat financiare tëpërmbajnë anomali materialedhe për të siguruar një marzh për anomalitë e mundshme të pazbuluara. Anomalia e tolerueshme është zbatimi i materialitetit të performancës, përcaktuar sipas SNA 320<sup>2</sup>, për një procedurë të vecantë në zgjedhjen e kampionit. Anomalia e tolerueshme mund të jetë e njëjta vlerë ose një vlerë më e ulët se materialiteti i performancës.

### Përcaktimi i Kampionit, Madhësia dhe Zgjedhja e Elementëve për tu Testuar

*Përcaktimi i Kampionit* (Ref: Para. 6)

- A4. Zgjedhja në auditim i krijon mundësi audituesit të sigurojë dhe vlerësojëevidencat e auditimit rreth disa karakteristikave që lidhen me elementët e përzgjedhur me qëllim

---

<sup>2</sup>SNA 320, *Materialiteti në Planifikimin dhe Kryerjen e një Auditimi*, paragrafi 9.

që të formojë ose ndihmojë në formimin e një konkluzioni në lidhje me popullatën nga e cila kampioni është përzgjedhur. Zgjedhja në auditim mund të zbatohet duke përdorur si zgjedhjen jo-statistikore ashtu dhe atë statistikore.

- A5. Në përcaktimin e një zgjedhje në auditim, vëmendja e audituesit përfshin qëllimin specifik që duhet arriur dhe kombinimin e procedurave të auditimit që kanë të ngjarë të arrijnë më së miri këtë qëllim. Shqyrtimi i natyrës së evidencës së kërkuesit të auditimit dhe kushtet e anomalisë ose devijimit të mundshëm dhe karakteristikave tjera që kanë të bëjnë me këtë evidencë auditimie ndihmojnë audituesin në përcaktimin se çfarë përbën një devijim ose anomali dhe çfarë popullate të përdorë për kampionin. Në përmbushje të kërkesave të paragrafit 9 të SNA 500, kur përdor zgjedhjen në auditim, audituesi kryen procedura auditimi për të siguruar të dhëna që popullata nga e cila është përzgjedhur kampioni është e plotë.
- A6. Shqyrtimi nga ana e audituesit i qëllimit të procedurave të auditimit, siç kërkohet në paragrafin 6, përfshin një kuptim të qartë të asaj se çfarë përbën një anomali apo devijim, në mënyrë që të gjithë, dhe vetëm, ato kushte që janë të përshtatshëm për qëllimin e procedurave të auditimit të përfshihen në vlerësimin e devijimeve apo përcaktimin e anomalive. Për shembull, në një test të të dhënave në lidhje me ekzistencën e llogarive të arkëtueshme, të tilla si konfirmimi, pagesat e bëra nga klienti përpara datës së konfirmimit, por të marra menjëherë pas kësaj date nga entiteti, nuk konsiderohen si anomali. Gjithashtu, një deklaram gabim mes llogarive të klientëve nuk ndikon në gjendjen totale të llogarive të arkëtueshme. Prandaj, mund të mos jetë e përshtatshme që kjo të konsiderohet si një anomali në vlerësimin e rezultateve të kampionit për këtë procedurë të veçantë të auditimit, edhe pse mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në fusha të tjera të auditimit, të tilla si vlerësimi i rrezikut të mashtrimit ose vlerësimi i mjaftueshmërisë së provizioneve për llogaritë e dyshimta.
- A7. Në shqyrtimin e karakteristikave të një popullate, për testet e kontrolleve, audituesi bën një vlerësim të normës së pritur të devijimit bazuar në kuptimin nga ana e audituesit të kontrolleve përkatëse ose në ekzaminimin e një numri të vogël të elementëve nga popullata. Ky vlerësim bëhet në mënyrë që të përcaktohet një kampion për auditimin si dhe të përcaktohet madhësia e kampionit. Për shembull, nëse norma e pritur e devijimit është papranueshmërisht e lartë, audituesi do të vendosë normalisht të mos kryejë testet e kontrolleve. Në mënyrë të ngjashme, për testet e të dhënave, audituesi bën një vlerësim të anomalisë së pritshme në popullatë. Në qoftë se anomalia e pritshme është e lartë, ekzaminimi 100 për qind ose përdorimi i një madhësie të gjërë kampioni mund të jetë i përshtatshëm në kryerjen e testeve të të dhënave.
- A8. Në shqyrtimin e karakteristikave të një popullate nga e cila është përzgjedhur kampioni, audituesi mund të përcaktojë se shtresëzimi apo zgjedhja e vlerës së ponderuar është e përshtatshme. Shtojca 1 paraqet trajtim të mëtejshëm të shtresëzimit dhe zgjedhjes së vlerës së ponderuar.

A9. Vendimi nëse do të përdorë metodën e zgjedhjes statistikore ose atë jo-statistikore mbetet një çështje që i përket gjykimit të audituesit; megjithatë madhësia e kampionit nuk është një kriter i vlefshëm për dalliminndërmjet metodës statistikore dhe asaj jo-statistikore.

*Madhësia e Kampionit (Ref: Para. 7)*

A10. Niveli i rrezikut në zgjedhjen e kampionit që audituesi është igatshëm të pranojë ndikon nëmadhësinë e kërkuar të kampionit. Sa më i ulët të jetë rreziku që audituesi është i gatshëm të pranojë, aq më e madhe do të duhet të jetë madhësia e kampionit.

A11. Madhësia e kampionit mund të përcaktohet nga zbatimi injë formule statistikore ose përmes ushtrimit të gjykimit profesional.Shtojcat 2dhe 3 tregojnë ndikimet që faktorët e ndryshëm në mënyrë tipike kanë në përcaktimin e madhësisë së kampionit. Kur rrethanat janë të ngjashme, efekti në madhësinë e kampionit i faktorëve të tillë si ata të identifikuar në shtojcën 2 dhe 3 do të jetë i ngjashëm pavarësisht faktit nëse është zgjedhur metoda statistikore apo jo-statistikore.

*Përzgjedhja e Elementëve për t'u Testuar (Ref: Para. 8)*

A12. Me metodën e zgjedhjes statistikore, elementët e kampionit përzgjidhennë mënyrë të tillë që çdo kampion të ketë një probabilitet të njohur për tu përzgjedhur. Me metodën jo-statistikore,përdoret gjykimi për të përzgjedhur elementët në zgjedhje. Duke qenë se qëllimi i zgjedhjes ështëqë të sigurojë një bazë të arsyeshme për audituesin nënxjerrjen e konkluzioneve rreth popullatës nga e cila kampioni është përzgjedhur, është e rëndësishme që audituesi të përzgjedhë një kampion përfaqësues, kështu që paragjykimi të shmanget duke zgjedhur kampionë që kanë karakteristikat tipike të popullatës.

A13. Metodrat kryesore të zgjedhjes së kampionëve janë përdorimi i tabelave të numrave rastësorëose TANK-et, zgjedhja sistematike dhe zgjedhja e rastit. Secila prej këtyre metodave ështëtrajtuar në Shtojcën 4.

**Kryerja e Procedurave të Auditimit (Ref: Para. 10-11)**

A14. Një shembull i cili tregon se kur ështëe nevojshme kryerja e procedurës mbi një element zëvendësues është ai i rastit kur njëçek i anuluarështë zgjedhur ndërkohë që kryhet testimi për evidencën e autorizimit të pagesës. Nëse audituesi bindet që çeku është i anuluar korrektësisht, pra kjo nuk përbën një devijim, ai ekzaminon një element zëvendësues.

A15. Një shembull i asaj kur audituesi nuk është në gjendje të zbatojëprocedurat e përcaktuara të auditimit mbi një element të përzgjedhur është ai kur dokumentacioni lidhur me atë element ka humbur.

A16. Një shembull i një procedure alternative të përshtatshme mund të jetë shqyrtimi i arkëtimit të mëvonshme bashkë me dëshmitë e burimit të tyre dhe të elementëve që janë menduar për tu paguar, kur ndaj një kërkesë për konfirmim pozitiv nuk është marrë asnjë përgjigje.

### **Natyra dhe Shkaku i Devijimeve dhe Anomalive (Ref: Para. 12)**

A17. Në analizimin e devijimeve dhe anomalive të identifikuar, audituesi mund të vëzhgojë që shumë prej tyre kanë një tipar të përbashkët, për shembull, lloji i transaksionit, vendndodhja, linja e produktit ose afati kohor. Në rrethana të tilla, audituesi mund të vendosët identifikojë të gjithë elementët në popullatë që zotërojnë tiparin e përbashkët dhe të zgjerojë procedurat e auditimit mbi këto elementë. Veç kësaj, të tilla devijime apo anomalitë mund të jenë të qëllimshme dhe mund të tregojnë mundësinë e mashtrimit.

### **Projektimi i Anomalive (Ref: Para. 14)**

A18. Audituesit i nevojitet të projektojnë anomalitë për popullatën për të siguruar një këndvështrim të gjerë të shkallës së anomalisë, por ky projektim mund të mos jetë i mjaftueshëm për të përcaktuar një shumë për t'u regjistruar.

A19. Kur një anomali është provuar si anormale, kjo mund të përjashtohet kur projektohen anomalitë për popullatën. Megjithatë, efekti i një anomalie të tillë, në qoftë se nuk është korrigjuar, kërkon ende të merret në konsideratë, përveç projektimit të anomalive jo-anormale.

A20. Për testet e kontrolleve, nuk është i nevojshëm asnjë projektim më vete i anomalive meqënëse norma e devijimit të kampionit është gjithashtu norma e devijimit të projektuar për popullatën si një e tërë. SNA 330<sup>3</sup> jep udhëzime kur devijimet nga kontrollet, mbi të cilat audituesi ka ndërmend të mbështetet, janë zbuluar.

### **Vlerësimi i Rezultateve të Kampionit (Ref: Para. 15)**

A21. Në rastin e testeve të kontrolleve, përveç rasteve kur është siguruar evidencë auditimi e mëtëjshme që provon vlerësimin fillestar, një nivel gabimi i lartë e i papritur, mund të çojë në rritje të nivelit të rrezikut të vlerësuar të anomalisë materiale. Në rastin e testeve të të dhënave, kur mungon evidenca e auditimit të mëtëjshëm, një vlerë gabimi e lartë dhe e papritur në një kampion mund ta shtyjë audituesin të besojë që një klasë transaksionesh ose një tepricë llogarie përmban anomali materiale.

A22. Në rastin e testeve të të dhënave, anomalia e projektuar plus anomalinë anormale, nëse ka të tilla, përbën vlerësimin më të mirë të audituesit për anomalitë në popullatë. Kur anomalia e projektuar plus anomalinë jonormale, nëse ka të tilla, e tejkalon anomalinë e tolerueshme, kampioni nuk siguron një bazë të arsyeshme për

<sup>3</sup>SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*, paragrafi 17.



nxjerrjen e konkluzioneve rreth popullatës që është marrë në testim. Sa më afër anomalisë së tolerueshme të jenë anomalia e projektuar plus anomalinëjonormale, aq më shumë mundësi ka që anomalia aktuale në popullatë të tejkalojë anomalinë e tolerueshme. Gjithashtu, nëse anomalia e projektuar është më e lartë se pritjet e audituesit rreth anomalisë së përdorur për të përcaktuar madhësinë e kampionit, audituesi mund të arrijë në përfundimin se ekziston një rrezik i papranueshëm lidhur me zgjedhjen e kampionit që anomalia aktuale në popullatë tejkalon anomalinë e tolerueshme. Marrja në konsideratë e procedurave të tjera të auditimit ndihmon audituesin të vlerësojë rrezikun që anomalia aktuale në popullatë tejkalon anomalinë e tolerueshme dhe që rreziku mund të ulet nëse evidenca shtesë të auditimit përdoren.

A23. Nëse audituesi arrin në përfundimin se zgjedhja në auditim nuk ka siguruar baza të arsyeshme për nxjerrjen e konkluzioneve rreth popullatës që është marrë në testim, audituesi mundet:

- t'i kërkojë drejtimit që të shqyrtojë anomalitë që janë identifikuar dhe mundësinë për anomali të mëtejshme dhe të bëjë rregullimet e nevojshme; ose
- të modifikojë natyrën, afatet dhe shtrirjen e procedurave të mëtejshme të auditimit për të arritur më së miri garancinë e kërkuar. Për shembull, në rastin e testeve të kontrolleve, audituesi mund të zgjerojë madhësinë e kampionit, të testojë një kontroll alternativ ose të modifikojë procedurat thelbësore përkatëse.

**Shtresëzimi dhe Zgjedhja me Vlerën e Ponderuar**

Në marrjen në konsideratë të karakteristikave të popullatës nga e cila është përzgjedhur kampioni, audituesi mund të vlerësojë se shtresëzimi ose zgjedhja me vlerën e ponderuar është e përshtatshme. Kjo Shtojcë paraqet udhëzime për audituesin lidhur me përdorimin e shtresëzimit dhe teknikave të zgjedhjes me vlerën e ponderuar.

**Shtresëzimi**

1. Efikasiteti në auditim mund të përmirësohet në qoftë se audituesi e shtresëzon popullatën duke e ndarë atë në nën-popullata të veçanta, të cilat kanë një karakteristikë dalluese. Objektivi i shtresëzimit është të zvogëlojë ndryshueshmërinë e elementëve brenda çdo shtrese dhe për rrjedhojë të lejojë madhësinë e kampionit që të zvogëlohet pa një rritje të rrezikut të zgjedhjes së kampionit.
2. Kur kryhen testet e të dhënave, popullata është shpesh e shtresëzuar sipas shumës monetare. Kjo lejon që përpjekje më të mëdha në auditim të drejtohen ndaj elementëve me vlera më të mëdha, duke qenë se këto elementë mund të përmbajnë mundësinë më të madhe të anomalive, në kushtet e zmadhimit. Në mënyrë të ngjashme, një popullatë mund të shtresëzohet sipas një karakteristike të veçantë, e cila tregon rrezik gabimi më të lartë, për shembull, kur testojmë lejimin për llogari të dyshimta të klientëve në vlerësimin e llogarive të arkëtueshme, tepricat e llogarive mund të shtresëzohen sipas vjetërsisë.
3. Rezultatet e procedurave të auditimit të zbatuara mbi një shembull të elementëve brenda një shtrese mund të projektohet vetëm për këto elementë që formojnë atë shtresë. Për të nxjerrë një konkluzion mbi të gjithë popullatën, audituesi duhet të marrë në konsideratë rrezikun e anomalisë materiale në raport me shtresat e tjera që formojnë të gjithë popullatën. Për shembull, 20 për qind e elementëve në një popullatë mund të përbëjnë 90 për qind të vlerës së një teprice llogarie. Audituesi mund të vendosë që të ekzaminojë një kampion të këtyre elementëve. Ai vlerëson rezultatet e këtij kampioni dhe arrin konkluzionin për 90 për qind të vlerës në mënyrë të ndarë nga pjesa e mbetur prej 10 për qind (për të cilën do të përdoret një kampion i mëtejshëm apo mënyra të tjera të mblledhjes së evidencës së auditimit, ose mund të konsiderohet jo-materiale).
4. Nëse një kategori e transaksioneve ose tepricë llogarie është ndarë në shtresa, anomalia projektohet për secilën shtresë më vete. Anomalitë e projektuara për secilën shtresë kombinohen më tej kur merren në konsideratë ndikimi i mundshëm i anomalive në tërësinë e kategorisë së transaksioneve apo tepricës së llogarisë.

**Zgjedhja me Vlerën e Ponderuar**

5. Në kryerjen e testeve të të dhënave mund të jetë efikase të identifikohet kampioni si njësi monetare individuale që formojnë popullatën. Pasi të ketë zgjedhur njësitë monetare të veçanta nga brenda popullatës, për shembull, në tepricën e llogarive të arkëtueshme, audituesi shqyrton elementët e veçantë, për shembull tepricat individuale të llogarive që përmbajnë këto njësi monetare. Një përfitim i kësaj mënyre në përcaktimin e kampionit është që përpjekja e auditimit të orientohet drejt elementëve me vlerë më të lartë sepse ato kanë një mundësi më të madhe për tu përzgjedhur dhe mund të rezultojnë në madhësi kampioni të vogël. Kjo mënyrë mund të përdoret në lidhje me metodën sistematike të zgjedhjes së kampionit (përshkruar në Shtojcën 4) dhe është më efikase kur zgjedhja e elementeve bëhet duke përdorur TANK-et.

**Shembuj të Faktorëve që Influencojnë në Madhësinë e Kampionit për Testet e Kontrolleve**

Më poshtë po renditim faktorët që audituesi merr në konsideratë për të përcaktuar madhësinë e kampionit për testet e kontrolleve. Këta faktorë, të cilët duhet të merren në konsideratë në tërësinë e tyre, presupozohet që nuk e detyrojnë audituesin të modifikojë natyrën dhe afatet e testeve të kontrolleve, apo në të kundërt të modifikojë metodën e kryerjes së procedurave thelbësore në përgjigje ndaj rreziqeve të vlerësuara.

FAKTORI	EFEKTI NË MADHËSINË E KAMPIONIT	
1. Një rritje e masës në të cilën vlerësimi i rrezikut të audituesit merr në konsideratë kontrollet e përshtatshme.	Rritje	Sa më shumë siguri që audituesi synon të fitojë nga efikasiteti operativ i kontrolleve, aq më i ulët do të jetë vlerësimi i audituesit lidhur me rrezikun e anomalisë materiale dhe si rrjedhim më e lartë do të duhet të jetë madhësia e kampionit. Kur vlerësimi i audituesit për rrezikun e anomalisë materiale në nivelpohimi përfshin një pritshmëri lidhur me efikasitetin operativ të kontrolleve, atëherë audituesi është i detyruar të kryejë teste të kontrolleve. Në kushtet kur aspektet e tjerë mbeten të njëjtë, sa më e lartë të jetë siguria që audituesi vendos në efikasitetin operativ të kontrolleve në vlerësimin e rrezikut, aq më e madhe do të jetë shtrirja e testeve të kontrolleve të audituesit (dhe si pasojë, madhësia e kampionit rritet).
2. Një rritje në normën e tolerueshme të devijimit.	Zvogëlim	Sa më e ulët të jetë norma e tolerueshme e devijimit, aq më e madhe duhet të jetë madhësia e kampionit.
3. Një rritje në normën e pritshme të devijimit të popullatës që do të testohet	Rritje	Sa më e lartë të jetë norma e pritshme e devijimit, aq më e madhe do të duhet të jetë madhësia e kampionit, në mënyrë që audituesi të jetë në gjendje për të bërë një vlerësim të arsyeshëm të normës aktuale të

ZGJEDHJA NË AUDITIM

		<p>devijimit. Faktorët që kanë të bëjnë me gjykimin e audituesit lidhur me normëne pritshme të devijimit përfshijnë njohjen që audituesika për biznesin (në veçanti, procedurat e vlerësimit të rrezikut të ndërmarra për të siguruar një kuptim të kontrollit të brendshëm), ndryshimet në staf ose nëkontrolline brendshëm, rezultatet e procedurave të auditimit të zbatuara në periudhat e mëparshme dhe rezultatet e procedurave të tjera të auditimit. Normat të pritshme të devijimit të kontrollit në nivele të larta zakonisht garantojnë pak, në mos asnjë, zvogëlim të rrezikut të vlerësuar të anomalisë materiale.</p>
<p>4. Një rritje në nivelin e dëshiruar të sigurisë së audituesit që norma e tolerueshme e devijimit nuk është tejkaluar nga norma aktuale e devijimit në popullatë</p>	<p>Rritje</p>	<p>Sa më i lartë të jetë niveli i sigurisë që audituesi dëshiron që rezultatet e kampionit të jenë në fakt tregues të ndodhjes aktuale të devijimit në popullatë, aq më e madhe nevojitet te jetë madhësia e kampionit.</p>
<p>5. Një rritje në numrin e kampionëve në popullatë</p>	<p>Efekt i papërfillshëm</p>	<p>Për popullata më të mëdha, madhësia aktuale e popullatës ka pak, në mos anjë, ndikim në madhësinë e kampionit. Për popullata më të vogla megjithatë, zgjedhja në auditim mund të mos jetë aq e efektshme sa mjetet alternative të sigurimit të evidencave të mjaftueshme e të duhura të auditimit.</p>

**Shembuj të Faktorëve që Influencojnë në Madhësinë Kampionit për Testet e Detajeve**

Më poshtë janë renditur faktorët që audituesi merr në konsideratë kur përcakton madhësinë e kampionit për testet e detajeve. Këta faktorë, të cilët duhet të merren në konsideratë në tërësinë e tyre, presupozojnë që audituesi nuk do të modifikojë metodën për të testuar kontrollet ose ndryshe të modifikojë natyrën ose afatet e procedurave thelbësore në përgjigje ndaj rreziqeve të vlerësuara.

FAKTORI	EFEKTI NË MADHËSINË E KAMPIONIT	
1. Një rritje në vlerësimin e audituesit të rrezikut të anomalisë materiale	Rritje	Sa më i lartë të jetë vlerësimi i bërë nga audituesi për rrezikun e anomalisë materiale, aq më e madhe duhet të jetë madhësia e kampionit. Vlerësimi i audituesit për rrezikun e anomalisë materiale ndikohet nga rreziku i vetvetishëm dhe rreziku i kontrollit. Për shembull, në qoftë se audituesi nuk kryen testet e kontrolleve, vlerësimi i rrezikut që ai bën, për operimin efektiv të kontrolleve të brendshme në lidhje me një pohim të veçantë, nuk mund të zvogëlohet. Prandaj, për të zvogëluar rrezikun e auditimit në një nivel të ulët të pranueshëm, audituesi kërkon një rrezik të ulët mos-zbulimi dhe do të mbështetet më shumë në procedurat thelbësore. Sa më e madhe të jetë evidenca e auditimit e marrë nga testet e detajeve (që do të thotë më pak rrezik mos-zbulimi) aq më e madhe kërkohet të jetë madhësia e kampionit.
2. Një rritje në përdorimin e procedurave të tjera thelbësore të drejuara në të njëjtin kërkim	Zvogëlim	Sa më shumë të mbështetet audituesi në procedurat e tjera thelbësore (testet e detajeve ose procedurat analitike thelbësore) për të zvogëluar në një nivel të pranueshëm rrezikun e mos-zbulimit në lidhje me një popullatë të veçantë, aq më pak siguri audituesi do të kërkojë nga zgjedhja në auditim dhe si pasojë, më e vogël

ZGJEDHJA NË AUDITIM

		mund të jetë madhësia e kampionit.
3. Një rritje në nivelin e kërkuar të sigurisë nga audituesi që anomalia e tolerueshme nuk është tejkaluar nga anomalia aktuale në popullatë	Rritje	Sa më e madhe të jetë shkalla e kërkuar e besueshmërisë të audituesit në atë që rezultatet e kampionit pasqyrojnë shumën reale të anomalive në popullatë, aq më e madhe kërkohet që të jetë madhësia e kampionit.
4. Një rritje në anomalinë e tolerueshme	Zvogëlim	Sa më e ulët të jetë anomalia e tolerueshme, aq më e madhe kërkohet të jetë madhësia e kampionit.
5. Një rritje në totalin e anomalisë që audituesi pret të gjejë në popullatë	Rritje	Sa më e lartë të jetë shuma e anomalisë që audituesi mendon të gjejë në popullatë, aq më e madhe kërkohet që të jetë madhësia e kampionit në mënyrë që ai të bëjë një vlerësim të arsyeshëm të shumës faktike të anomalisë në popullatë. Faktorët që lidhen me marrjen në konsideratë nga ana e audituesit të shumës së anomalisë së pritshme përfshijnë shtrirjen në të cilën vlerat e elementëve janë përcaktuar subjektivisht, rezultatet e procedurave të vlerësimit të rrezikut, rezultatet e testeve të kontrolleve, rezultatet e procedurave të auditimit të zbatuara në periudhat e mëparshme dhe rezultatet e procedurave të tjera thelbësore.
6. Shtresëzim i popullatës kur është e përshtatshme	Zvogëlim	Kur ka një shtrirje të gjerë (ndryshueshmëri) në madhësinë monetare të elementëve në popullatë, mund të jetë e dobishme të shtresëzohet popullata. Kur një popullatë mund të shtresëzohet në mënyrën e duhur, totali i madhësive të kampionit, të marra nga shtresat, përgjithësisht do të jetë më i vogël se sa madhësia e kampionit që do të kërkohet për të arritur një nivel të dhënë të rrezikut të zgjedhjes në auditim, nëse një kampion do të merrej nga e gjithë popullata.
7. Numri i njërive të kampionit në popullatë	Efekt i papërfillshëm	Për popullata të mëdha, madhësia faktike e popullatës ka pak efekt, në

ZGJEDHJA NË AUDITIM

		<p>mos asnjë, në madhësinë e kampionit. Kështu, për popullata të vogla, zgjedhja në auditim shpesh nuk është aq efektive sa do të ishte një metodë alternative e mbledhjes së evidencës së mjaftueshme të përshtatshme të auditimit.</p> <p>(Megjithatë, kur kampioni ka të bëjë me shuma monetare, një rritje në vlerën monetare të popullatës e rrit madhësinë e kampionit, përveç nëse kjo është kompensuar nga një rritje proporcionale në materialitet për pasqyrat financiare si një e tërë [dhe, nëse është e zbatueshme, niveli ose nivelet e materialitetit për klasa të veçanta transaksionesh, teprica llogarish ose dhënie informacionesh].)</p>
--	--	--



**Metodat e Zgjedhjes së Kampionit**

Për zgjedhjen e kampionit ekzistojnë shumë metoda, por metodat bazë paraqiten si më poshtë:

- (a) Zgjedhja Rastësore (përdorur gjatë gjeneruesve të numrave rastësorë, për shembull, nga tabelat e numrave rastësorë).
- (b) Zgjedhja Sistematike, në të cilën numri i njërive të kampionit në popullatë është i ndarë sipas madhësisë së kampionit për të dhënë një interval zgjedhjeje, për shembull 50, ku është përcaktuar një pikë fillestare brenda 50 të parave dhe cdo njësi e 50-të pas kësaj përzgjidhet. Ndonëse pika fillestare mund të jetë përcaktuar në mënyrë të rastësishme, kampioni ka shumë të ngjarë të jetë vërtet i rastësishëm në qoftë se është përcaktuar nga përdorimi i gjenerimit rastësor të numrave në kompjuter ose nga tabelat e numrave rastësorë. Kur përdoret zgjedhja sistematike, audituesit do t'i duhet të përcaktojnë që njësitë e kampionit brenda popullatës nuk janë strukturuar në atë mënyrë që intervali i zgjedhjes të korrespondojë me një model të veçantë në popullatë.
- (c) Zgjedhja me Njësi Monetare është një tip i zgjedhjes sipas vlerës së ponderuar (siç përshkruhet në Shtojcën 1), në të cilën madhësia e kampionit, përzgjedhja dhe vlerësimi rezultojnë në një përfundim në shuma monetare.
- (d) Zgjedhja e Rastit, në të cilën audituesi përzgjedh kampionin pa ndjekur një teknikë të strukturuar. Megjithatë nuk përdoret asnjë teknikë e strukturuar, audituesi do të shmangë megjithatë çfarëdo gjykimi të vetëdijshëm ose parashikueshmëri (për shembull, shmangien e vështirësisë për gjetjen e elementëve, ose gjithmonë duke zgjedhur ose evituar hyrjet e para apo të fundit në një faqe) dhe në këtë mënyrë tenton të sigurojë që të gjithë elementët në popullatë kanë një mundësi përzgjedhjeje. Zgjedhja e Rastit nuk është e përshtatshme kur përdoret zgjedhja statistikore.
- (e) Zgjedhja në Bllok përfshin zgjedhjen e një ose disa blloqeve të elementëve të afërt nga brendësia e popullatës. Zgjedhja në bllok, zakonisht, nuk mund të përdoret në zgjedhjen në auditim sepse shumica e popullatave janë të strukturuar në mënyrë të atillë ku elementët e renditur mund të mendohen të kenë karakteristika të ngjashme me njëri tjetrin, por karakteristika të ndryshme nga elementët që ndodhen tjetërkund në popullatë. Megjithatë në disa rrethana, ajo mund të jetë një procedurë e përshtatshme auditimi për të shqyrtuar një bllok të elementëve, rrallë kjo do të ishte një teknikë e duhur përzgjedhjeje kur audituesi ka si qëllim të nxjerrë konkluzione të vlefshme rreth tërë popullatës bazuar në një kampion.